



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr.984/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përbarimore të kreditorit Kompania Rajonale Ujësjellësi “Prishtina”, SH.A., me seli në Prishtinë, rruga “Hazir Shala”, nr.4, kundër debitorit “SËËET POP” Sh.p.k, me seli në Lipjan, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.452/21 të datës 25.01.2021, të Përbaruesit Privat Valdrin Beka, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 29.06.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET POSHTË si i pa afatshëm prapësimi i debitorit “SWEET POP” Sh.p.k, i ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.452/21 të datës 25.01.2021, të Përbaruesit Privat Valdrin Beka.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Kompania Rajonale Ujësjellësi “Prishtina”, SH.A., ka caktuar urdhrin përbarimor P.nr.452/21 të datës 25.01.2021, duke lejuar përbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm - Ekstrakti i verifikuar nga librat afariste, Kartela Financiare e Konsumatorit me Nr. J107129, nga data 01.01.2013 deri me datë 22.03.2021, me të cilin e ka urdhëruar debitorin, që brenda afatit prej 7 ditësh pas pranimit të urdhrin, t’ia paguaj kreditorit shumën prej 2,183.40 €, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore, në të kundërtën përbarimi të realizohet me ndalimin e mjeteve të cilat debitori i ka në xhirollogaritë bankare dhe bartjen e shumës përkatëse në llogarinë e kreditorit në “....” nr., ndërsa nëse debitori nuk ka mjete në llogarinë e tij përbarimi të realizohet me konfiskimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme të debitorit deri në vlerën e borxhit.

Kundër urdhrin për lejimin e përbarimit me datë 03.07.2021 prapësim ka paraqitur debitori “SWEET POP” Sh.p.k, me të cilën e ka kontestuar urdhrin për përbarim duke theksuar se kreditori nuk i ka përmbushur kërkesat për mbulimin e kërkesave afariste të debitorit. Ne vazhdim deklaron se ka pasur mungesa të furnizimit me ujë të pijshëm, dëmtime në sistemin e

ujësjellësit e cila ka shkaktuar probleme financiare dhe funksionale te debitorit. Andaj kërkon ristrukturim dhe marrëveshje për shlyerjen e borxhit ndaj Kompania Rajonale Ujësjetllësi “Prishtina”, SH.A.

Kreditori paraqet përgjigje në prapësim ku e cilëson prapësimin si të pabazuar dhe të pa argumentuar në ligj pasi që nuk mbështetet ne prova sipas nenit 69 par.4 te LPP-së. Tutje thekson se prapësimi është ushtruar jashtë afatit ligjor pasi qe i ka pranuar shkresat e lendes me datë 21.06.2021 ndërsa prapësimin e ka dorëzuar me date 06.07.2021. Andaj i propozon Gjykatës që prapësimin ta refuzoj si të pabazë, te obligohet debitori ta kryej borxhin ndaj kreditorit dhe në rast të ankesës t’i caktoj shumën e garancionit deri në vlerën e propozimit sipas nenit 77 par.5 dhe nenit 78 par.1.2 të LPP-së.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se prapësimi i debitorit është i pa afatshëm për arsyet si në vijim:

Sipas vlerësimit të Gjykatës, debitori Urdhrin Përmbarrimor P.nr.452/21 të datës 25.01.2021, të Përmbarruesit Privat Valdrin Beka me seli në Prishtinë, e ka pranuar me datë 21.06.2021, e cila vërtetohet nga komunikimet me postë elektronike të përmbarruesit privat drejtuar debitorit që gjenden në shkresat e lëndës, ndërsa prapësimi nga ana e debitorit është ushtruar me datën 03.07.2021.

Sipas dispozitës së nenit 70 të Ligjit për Procedurën Përmbarrimore përcaktohet se “ *Prapësimi duhet t’i paraqitet Gjykatës brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit të vendimit përmbarrues ose urdhrin përmbarrues*”, ndërsa me nenin 126 par. 2 të LPK-së, përcaktohet se “ *Në qofte se afati është caktuar me ditë, përjashtohet nga llogaritja dita në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të filloj afati, kështu që për fillim të afatit merret dita e parë e ardhshme.*”

Andaj duke marrë parasysh faktin se në rastin konkret debitori urdhrin përmbarrimor P.nr.452/21 të datës 25.01.2021 e ka pranuar me datën 21.06.2021 ndërsa afati për paraqitjen e prapësimit ka filluar të rrjedhë nga data 22.06.2021 rezulton se dita e fundit për paraqitjen e prapësimit ka qenë data 28.06.2021.

Meqenëse në rastin konkret debitori prapësimin e ka paraqitur me datën 03.07.2021 e cila vërtetohet nga vula e postës vendosur në zarfin drejtuar përmbaruesit, ndërsa në shkresa të lëndës nuk ka prova se prapësimi është dorëzuar edhe në mënyra tjera të përcaktuara për dërgimin e shkresave, rezulton se debitori prapësimin e ka paraqitur me 12 ditë vonesë.

Andaj bazuar në të lartcekurat, gjykata konform nenit 73 par. 3 të LPP-së, dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti i Përgjithshëm

KPPP.nr.984/22, datë 29.06.2023.

Gjyqtari
Gent Beker

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimin të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.